

MINISTRI

URDHER

Nr. 384 datë 21.10 2015

**PËR
MBLEDHJEN E TË ARDHURAVE PËR TARIFAT E VEPRIMTARISË KRYESORE
TË AGJENCISË E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK**

Ne vijim të memos 4189/3, datë 23.09.2015 të Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Kulturës, në mungesë të një baze ligjore specifike për të hartuar një projektvendim për miraim tarifash, si dhe duke qënë se mbledhja e traifave që vinë nga veprimtaria kryesore e ASHA sjell efekte pozitive për buxhetin e shtetit,

KONSTATOVA:

Se është e nevojshme nxjerrja e nje urdhri për rregullimin e veprimtarisë me efekt pozitiv financiar,

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

URDHEROJ:

1. Mbledhjen e të ardhurave për tarifat e veprimtarisë kryesore të Agjencisë e Shërbimit Arkeologjik (ASHA), sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Te vijohet mbledhja e të ardhurave nga veprimtaria kryesore e ASHA, deri ne rregullimin e situatës ligjore specifike me hyrjen ne fuqi të ligjit te ri “Për trashëgiminë kulturore”
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Disveristetin Kulturor për njoftimin e këtij Urdhri.
4. Ngarohet Agjencia e Shërbimit Arkeologjik per zbatimin e tij dhe grupi i punës për zbatimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Mirela KUMBARO FURXHI





Lidhja nr.1

Nr	EMERTIMI I TARIFES	Masa e tarifës në % për buxhetin e shtetit	Masa e tarifës në % për ASHA	Baza e tarifës	Vlera ne leke
A	Të ardhura nga veprimtaria kryesore				
1	TARIFA E APLIKIMIT PER NJE PROJEKT	100%	0%	1 dosje aplikimi	10,000
2	TARIFA E APLIKIMIT PER LICENSE ARKEOLOGU	100%	0%	1 dosje licensimi	10,000
3	TARIFE RREGJISTRIMI PËR LICENSA INDIVIDUALE ARKEOLOGU	100%	0%	License individuale	10,000
4	TARIFE RREGJISTRIMI PER SHOQERI TE LICENSUARA ARKEOLOGJIKE	100%	0%	License shoqërie	30,000
5	TARIFA MBIQYRJE NE TERREN NGA ASHA	100%	0%	1 dite pune/1-punonjës	16,440